

**Statuti
dhe
Akt Themelimi**

**i
Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**

“EL SUEÑO”

23.09.2023

S T A T U T I dhe A K T T H E M E L I M I

i

EL SUEÑO SH.P.K.

«**EL SUEÑO**» krijohet mbi bazën e statutit të hartuar nga vetë **Ortaku i Vetëm, znj. Elsa Ndoja**, e bija **Luigj** e **Liljana** e datëlindjes **17 prill 1975**, lindur në **Shkodër** e banues në **Shkodër** Rruga: **Kel Kodheli, Nr. 25, Shkodër** për të zhvilluar aktivitet ekonomik dhe fitimprurës; duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, e cila ka vendosur të përpilojë këtë statut:

Neni 1

Emërtimi

Aktiviteti ekonomik do të quhet «**EL SUEÑO**». **Sh.P.K.**
«**EL SUEÑO**» i lind e drejta të ushtrojë veprimtarinë e vet që nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar **QKR Shkodër**.

Neni 2

Fushat e veprimtarisë

Tregtim dhe prodhim pijesh të ndryshme jo alkolike të konfeksionuara dhe natyrale (lëngje frutash dhe çaji) apo ushqimesh çasti të ndryshëm (kryesisht panine, crep, piadina) të të gjitha llojeve me pakicë.

Neni 3

Vendndodhja dhe shtrirja e veprimtarisë

EL SUEÑO SH.P.K. e ka selinë tek **Shoqata e Jezuitëve në Shqipëri** Rruga e Jezuitëve, nd. 13, Zk. 8594, numër pasurie 4/199/ND, Shkodër.

Neni 4

Destinatarët e shërbimeve

Për kryerjen e veprimtarisë së vet **EL SUEÑO** ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj pranë institucioneve të ndryshme si skolla, qendra formimi, call center, ndërmarrje, etj, të ngjashme si këto

Neni 5

Kohëzgjatja e aktivitetit

Aktiviteti i **EL SUEÑO** do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar, pa afat.

Neni 6

Kapitali

Kapitali fillestar me të cilin do të fillojë aktivitetin **EL SUEÑO** është **100.000 (njëqind mijë) lekë** me **1 (një) kuotë**, me vlerë nominale **100.000 (njëqind mijë) lekë**, përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm, znj. Elsa Ndoja.

Kapitali përbëhet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe mjete të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të përcaktuar në këtë statut.

Neni 7

Fitimi i realizuar

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike do të administrohet nga ortaku i vetëm. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar.

EL SUEÑO është e detyruar të shlyejë të gjithë detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 8

Organi vendimmarrës

Organi vendimmarrës i **EL SUEÑO** është ortaku i vetëm. Ortaku i vetëm ka të njëjtat të drejta si Asambleja e ortakëve. Ai vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndarja e fitimit, ndryshimet në statut, zvogëlimi ose zmadhimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër, sipas ligjit, ndryshimi i vendndodhjes së selisë, etj.

Neni 9

Kompetencat e administratorit

Administrator i vetëm emërohet znj. Elsa Ndoja. Administratori qëndron për një periudhë 5 vjeçare në detyrë. Mandati i tij mund të rinovohet ose të ndërpritet me vendim të ortakut të vetëm. Ortaku i vetëm e gëzon të drejtën që të kryejë vetë edhe

detyrën e administratorit ose të emërojë/shkarkojë në çdo kohë një person tjetër në atë detyrë. Administratori ka këto kompetenca:

- përcaktimin e orientimeve kryesore të programit dhe buxhetit;
- miratimin e planeve dhe të llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në bazë të objektit të aktivitetit të **EL SUEÑO**;
- përcaktimin e propozimeve dhe të varianteve të kapitalit që do të paraqitet tek Ortaku i vetëm;
- përcaktimin e organikës drejtuese;
- krijimin e organizmave të tjera për realizimin e objektivave dhe funksioneve të **EL SUEÑO**;
- parapërgatitjen e propozimeve për ndërprerjen e aktivitetit të **EL SUEÑO**;
- përcaktimin e kërkesave të financimeve.

Neni 10

Viti financiar

Çdo vit financiar fillon në 1 janar të çdo viti dhe përfundon në 31 dhjetor të po atij viti, me përjashtim të vitit të parë dhe përfundimit, ku si fillim është data e regjistrimit dhe si mbarim data e përfundimit të afatit të **vitit ushtrimor**.

Neni 11

Bilanci dhe llogaria ekonomike

Administratori parashikon brenda datës **28 shkurt të vitit pasardhës** përfundimin e bilancit dhe llogarisë ekonomike duke i paraqitur tek Ortaku i vetëm për miratim.

Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiarë dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët, apo nga ekspertët kontabël, miratohen nga Ortaku i vetëm. Miratimi i dokumentave financiarë vjetorë bëhet brenda një afati 3-mujor, paas datës së mbylljes së vitit financiar.

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit, Ortaku i vetëm vendos e krijon fondin ligjor, por mund të krijojë edhe fonde të tjera. **EL SUEÑO** përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore, taksave lokale dhe detyrimeve të tjera që mund të caktohen me ligj. Ajo ka të drejtë të hapë llogari likuiduese pranë bankave të vendit dhe të kryejë veprime likuidimi me ta.

Neni 12

Punësimi

Marrëdhëniet e punësimit brenda **EL SUEÑO** rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në përputhje me Kodin e Punës dhe VKM-të e ndryshme në lidhje me punësimin.

Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës së **EL SUEÑO** si dhe duke njoftuar organet e punës të juridiksionit ku ushtron veprimtarinë e vet subjekti.

Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje disiplinore, ose me vetë kërkesën e të interesuarit. Largimi nga **EL SUEÑO** bëhet pasi janë shlyer të gjitha detyrimet materiale e monetare. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga ortaku i vetëm themelues.

Neni 13

Lidhja e kontratave të ndryshme

EL SUEÑO mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë, drejtpërdrejtë në tregun e lirë, si dhe me persona fizikë ose juridikë, OJF, etj vendas ose të huaj.

Në veprimet e kontraktuara, brenda dhe jashtë vendit, shoqëria përfaqësohet nga Ortaku i vetëm i tij, ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij me prokurë nga ortaku i vetëm.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për **EL SUEÑO**.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së **EL SUEÑO**, kur nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do të kalojnë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku është edhe Regjistri Tregtar i **EL SUEÑO**.

Neni 15

Ndryshimi i statusit

Ndryshimi i statusit të **EL SUEÑO** në një status tjetër bëhet me vendim të ortakut të vetëm, kur plotësohen kushtet e nevojshme për krijimin e statusit të të një lloji tjetër.

Neni 16

Mbledhja - Realizimi i të ardhurave të veprimtarisë ekonomike

EL SUEÑO

- do të hapë një llogari bankare e cila do të mbajë emrin **EL SUEÑO** pranë **Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) Shkodër**, pas regjistrimit të saj në **QKR**

Shkodër. Në një të ardhme nuk përjashtohet mundësia për të hapur llogari të tjera në emër të saj edhe në banka të tjera nëse nevojitet

Neni 17

Ortaku i vetëm, si themelues i **EL SUEÑO** mund të bëjë në çdo kohë ndryshime e plotësime në statut pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore me nenet e përshkruara në këtë statut. Ndryshimet e plotësimet bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

Neni 18

Për të gjitha çështjet e tjera të pa trajtuara në këtë statut, veprimtaria e **EL SUEÑO** do të mbështetet vetëm në legjislacionin shqiptar në fuqi, në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 dhe gjithë pjesa tjetër të legjislacionit shqiptar në fuqi, përfshirë edhe aktet ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 19

Ky statut i **EL SUEÑO** është përpiluar dhe nënshkruar në pesë kopje nga vetë përfaqësuesi i tij.

23 shtator 2023

Përfaqësuesi i

EL SUEÑO

Elsa Ndoja

Administrator

